

**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

| Nr. | Pozicioni i punës                         | Struktura e interesuar/<br>Forca   | Vendi ku ndodhet | Lloji i kontratës së punës | Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve |            | Afati i aplikimit |            |
|-----|-------------------------------------------|------------------------------------|------------------|----------------------------|-----------------------------------------|------------|-------------------|------------|
|     |                                           |                                    |                  |                            | Me dosje                                | Intervista | Fillimi           | Mbarimi    |
| 1   | <b>“Specialist programues/financier ”</b> | Reparti Ushtarak nr.4001,në Tiranë | Tiranë           | Pa afat                    | Po                                      | Po         | 18.08.2026        | 31.08.2026 |

Formulari nr. 1

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1.Pozicioni i punës: “Specialist programues/financier”, në Degën e Planifikimit (G-5/8).</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <b>2. Kodi i pozicionit:</b> N/A                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>3. Reparti/Institucioni:</b> Reparti Ushtarak nr.4001, në Komandën Mbështetëse, në Tiranë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <b>4. Vendi:</b> Tiranë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>5. Paga:</b> VKM nr.325, datë 31.05.2023, i ndryshuar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <b>6. Lloji i kontratës së punës:</b> Pa afat                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <b>7. Data e fillimit të aplikimit:</b> 18.08.2026                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <b>8. Data e mbylljes së aplikimit:</b> 31.08.2026                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <p><b>9. Mënyra e aplikimit:</b></p> <p>Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën <a href="http://www.mod.gov.al">www.mod.gov.al</a>. Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në:</p> <p><i>Drejtorinë e Burimeve Njerëzore</i></p> <p><i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i></p> <p><i>Tiranë</i></p> |

## 10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar sëbashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [www.mod.gov.al](http://www.mod.gov.al).(linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

## 11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojnë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

## 12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: “Specialist programues/financier” .
- b. Arsimi : Të ketë përfunduar arsimin e lartë në “Shkenca Ekonomike”/ “Financë”.
- c. Kualifikimi: Të ketë kualifikime në fushën e mësipërme.
- d. Trajnimi: Të ndryshme në lidhje me fushën e menaxhimit financiar.
- e. Eksperiencia në Punë: Eksperiencë pune mbi 3 vite.
- f. Gjuha e huaj: Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze.
- g. Kërkesa të tjera specifike: Aftësi shumë të mira të punës në grup dhe të përdor programeve kryesore të kompjuterit, Word, Excel, Power Point.
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: Sipas VKM nr.731 datë 27.11.2024 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e personelit”.

**Përshkrimi i punës:** Merret me planifikimin dhe menaxhimin financiar, si dhe përgatitjen dhe monitorimin e programeve dhe projekteve të institucionit.

**Detyrat kryesore:**

- Ka për detyrë të ndihmojë Shefin e Degës, ta këshillojë dhe të përgatisë për praktikën e punës, si dhe të japë mendime për problemet e programimit, buxhetit, çështjet ekonomiko-financiare, ato të fushës së administrimit si dhe zbatimin e kërkesave ligjore dhe m/ligjore për pagesat, shpërblimet, detyrimet, tatimet, gjokat, taksat, likuidimet, blerjet dhe kontratat.
- Siguron direktivat financiare dhe udhëheqjen teknike të zbatimit të tyre në veprimtarinë financiare të Komandës Mbështetëse.
- Udhëheq procesin e programimit dhe të planifikimit buxhetor.
- Shqyrton e miraton dokumentacionin e këtij procesi për të gjitha repartet e vartësisë dhe harton mbi këtë bazë përmbledhëset për raportim në instancat eprore.
- Studion detajimin e buxhetit të miratuar dhe ndjek zbatimin e ndryshimit të tij gjatë vitit për të gjitha strukturat vartëse.
- Harton listën e Integruar të Prioriteteve të Komandës Mbështetëse dhe ja prezanton atë strukturave të vartësisë të Komandës Mbështetëse.
- Ndjek detyrimet e Matricës së Veprimtarive për përgatitjen e programeve të Mbrojtjes dhe Listës së Integruar të Prioriteteve të Komandës Mbështetëse dhe strukturave të vartësisë.
- Harton planifikimin vjetor të Programimit të Mbrojtjes të Komandës Mbështetëse, dërgimin e tyre në strukturat e vartësisë të Komandës Mbështetëse.

**13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

**Vlerësimi i dokumenteve** të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

**Intervista** zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.